



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS ME RASTIN E SHËNIMIT TË 14-VJETORIT TË BETEJËS
SË KOSHARES, E MBAJTUR MË 8 PRILL 2013**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA
POVODOM OBELEŽAVANJE 14 GODIŠNJICE KOŠARSKE BITKE,
ODRŽANE 8. APRILA 2013. GODINE**

**PRILL - APRIL
2013**

(Mbledhjen solemne e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E nderuara presidente Jahjaga,
I nderuari kryeministër Thaçi,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misioneve diplomatike,
Të nderuar veteranë,
Të nderuara zonja e zotërinj,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Mirë se keni ardhur në seancën plenare me rastin e shënimit të 14-vjetorit të Betejës së Koshares.

Të nderuar të pranishëm, e ftoj deputetin Anton Quni që, si përfaqësues i propozuesit, ta marrë fjalën.

(Duartrokitje)

ANTON QUNI: E nderuara presidente Jahjaga,
I nderuar kryetar i Parlamentit Krasniqi,
Kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Thaçi,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Deputetë të Parlamentit të Kosovës,
Përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës,
Përfaqësues të korit diplomatik,
Familje të dëshmorëve Jashari, Pajaziti, Haradinaj, Ramadani, Çekaj, Fetaj, Thaçi, Hasi e të tjera,
Veteranë dhe invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Kolonel Berisha dhe stafi komandues i Betejës së Koshares,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Para 14 vjetëve, më 8 prill 1999, luftëtarët e Brigadës 131, 134 dhe Batalioni diversant e vëzhgues, të bashkuar me Grupin Operativ 3, pikërisht në këtë kohë po i merrnin instruksionet e fundit. Të gjitha përgatitjet kishin përfunduar. Pak orë na ndanin nga fillimi i operacionit. E pritnim terrin që të pavërejtur t'i zinin pozicionet.

Koha ishte e zymtë, me reshje, borë, shi, ftohtë, me frymë të lehtë. Malet e mbuluara me re. Ushtarët edhe një herë i kontrollojnë pajisjet, sasinë e municionit, armët, ndihmën e parë, mbrojtëset kundër helmit, helmetat e tjera.

Kryesisht, zotëron heshtja. Aty-këtu ndonjë batutë, pak të qeshura, prapë heshtja.

Minutat ishin të gjatë. 150 luftëtarë të ardhur nga katër anët e botës e shikonin njëri-tjetrin, duke i sjellë kujtimet nga fëmijëria, shkollat, dashurinë e parë, sherret, protestat, demonstratat, pajtimin e gjaqeve, mbylljen e shkollave, arrestimet, rrahjet, zhdukjet, ushtarët në arkivole, thyerjen e portave, britmat, krismat, rafalët, tanket, djegiet, ekzekutimet.

Kujtojnë vendimin për t'u mobilizuar, bekimin e prindërve, veshjen e uniformës, komandat shqip, përgatitjet, stërvitjet, mësimet nga shkenca dhe arti i luftës, aksionet e para, betimin e luftëtarit, qepjen në krah të emblemës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në orët e para të 9 prillit, heshtjen e thyen komanda: Nisemi! Togjet, skuadrat, grupet, vëzhguesit, minierët, diversantët, snajperistët, kundërajrorët, kundërblindët, artiljerët, komunikuesit, transportuesit, teknikët, mjekët - lëvizin, marshojnë, vrapojnë, infiltrohen, zënë pozicionet dhe prapë bien në heshtje.

Me rrezet e para të diellit, në komandën 'Zjarr' shpërthen e tërë energjia e mbledhur me dekada e dhimbjeve, lotëve, poshtërimit, ndarjeve dhe okupimit. Detonimet, plasjet, rafalët, predhat, breshëritë, flaka - bien mbi pozicionet e forcave të armikut.

Hapen kalimet në fushat e minuara, rrjetat me gjemba, krijohen krateret, shemben transhetë, rrafshohen bunkerët, eliminohen pozicionet e zjarrit.

Luftëtarët tanë i kapin objektet një nga një: Kokën, Maja e Kokës, Shkozën, Rrasën e Koshares, Gomurët, Mriqën, Gushën. Piramidat e kufirit bien njëra pas tjetrës.

Në ditën e dytë, batalioni 54 kufitar i Armatës jugosllave, prej 350 ushtarakëve, ishte në rrethimin e hekurt brenda karaulës. Ata po kërkonin ndihmë nga njësitë operative në thellësi.

Nga mesazhi i kapur me mjete të përgjimit, dëgjojmë: "Mbahuni, po i dërgojmë njësitë më të fuqishme. Mos u frikoni! Ata ende janë në kohën e feudalëve, do i përplasim në det".

Po vërtetohej teza se ushtarakët serbë ishin bërë viktimat të gënjeshtreve dhe të historianëve, letrarëve dhe politikanëve serbë.

Ata nuk e dinin të vërtetën e popullit shqiptar. Nuk besonin se historianët e lashtë na përshkruanin si zotëruesit e deteve, se në krye me Aleksandrin e Madh ne eksploruam Lindjen e Mesme dhe rrjedhën e lumit Nil. Se mbreti i Epirit, Pirro, ishte njohësi më i mirë i artit ushtarak në kohën antike. Se ushtaraku iliro-dardan Konstandini e arriti famën në krye të legjioneve romake në Britani.

Ata shumë pak dinin për famën e Komnenëve, për Gjergj Kastriotin Skënderbe, për jeniçerët shqiptarë, për batalionin shqiptar të Napoleonit, për stratotët e Republikës së Venedikut, për legjendat e arvanitasve De More dhe Beoti, e shumë e shumë beteja historike dhe heroike të shqiptarëve anekënd Gadishullit Ballkanik, në luftërat për çlirimin e kombit.

Ata tani do të binden edhe vetë se ishin viktimë e miteve të rrejshme, kur batalioni 54 kufitar i Armatës jugosllave do të fshihet nga faqja e dheut. Në karaulën famëkeqe, nga ku ishin organizuar shumë ekspedita ndëshkuese kundër popullatës do të ngrihet në shenjë fitoreje flamuri i kombit shqiptar.

Shumë shpejt, në regjionin e gjerë të Koshares, në Bjeshkët e Junikut, në anën jugore të Alpeve Shqiptare dhe nga Rrafshi i Dukagjinit do të vërsulet e tërë makineria ushtarake dhe policore e armikut, e përbërë nga brigada 125 e mekanizuar, nga brigada 63 e parashutistëve, brigada 72 për operacione të veçanta, batalioni diversant e vëzhgues, batalioni i policisë ushtarake me tërë arsenalin luftarak - artileri, sisteme raketore, aviacion, tanke, transportues, helme e tjera.

Fillimisht paralajmëronin me pompozitet dhe demonstrim të forcës, të përcjellë me këngë, por duke hyrë thellë në zonën e luftimeve i lëshonte forca. Zëri iu shterëj dhe teknika nuk u bënte punë.

Ata ktheheshin mbrapa, të përgjysmuar, të përkulur, duke u tërhequr zvarrë.

Për 70 ditë me radhë, në luftimet e përditshme, Brigada 138 “Agim Ramadani”, nga radhët e veta i kishte humbur 114 luftëtarë. Por, tani numëronte 2 500 luftëtarë të përhershëm, të përgatitur dhe të pajisur mirë, me përvojë të madhe, me besim të palëkundur me stafin komandues.

Vija e frontit në gjatësi 20-22 kilometra ishte stabile. Në hapësirën e liruar organizohej jeta e përditshme. Ne i mbanim pozicionet dominuese dhe mund të godisnim deri në 20 kilometra largësi.

Forca e zjarrit ishte e fuqishme. Tani ishim në gjendje t’i ndanim në dysh forcat serbe në Rrafshin e Dukagjinit.

Këtë gjë e dinin edhe analistët ushtarakë të Serbisë. E dinin edhe ushtarakët rusë të dërguar si ekspertë në ndihmë forcave serbe, 2 nga të cilët u vranë në fshatin Koshare.

Të vetëdijshëm se Brigada 138 dhe njësitë tjera të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës tani mund të ndërmarrin operacione më komplekse dhe duke e studiuar forcën mobilizuese të rekrutëve të rinj që vinin nga të gjitha anët e botës, ata u përpoqën që një ditë para kapitullimit edhe një herë ta bindin faktorin politiko-ushtarak të NATO-s se nuk ia vlen të ndërhyjë për shqiptarët, për një popull agresiv dhe luftënxitës, jo human dhe vetjak, qyqar dhe të frikshëm, të përçarë në fise, bajraqe, fe, parti, fraksione. Ushtarakët serbë ishin në pritje të përgjigjes.

Një ushtarak i NATO-s del nga errësira e një këndi të tendës dhe në tavolinën përballë oficerëve serbë e përplas një dosje. Këtu shkruan ndryshe! Këtu thuhet se është popull paqësor dhe shembulli më i mirë është presidenti i tyre, simboli i paqes dhe rezistencës paqësore, doktor Ibrahim Rugova. Këtu shkruan se janë humanë dhe popull solidar dhe shembullin më të mirë e kanë bijën e tyre dhe nënën e botës, Nënë Terezë. Ju i quani qyqarë dhe frikacakë, por ne do të mësojmë për guximin, trimërinë, fisnikërinë dhe bujarinë e komandantit të tyre legjendar, Adem Jashari, për Hamzë Jasharin, Zahir Pajazitin, Ilir Konushevcin, Ahmet Krasniqin, vëllezërit Haradinaj, Fehmi e Xhevdet Lladrovcin, Iljaz Kodrën, Gaspër Karaçin, Edmond Hoxhën, Mujë Krasniqin, vëllezërit Lleshi e shumë e shumë të tjerë.

Ju thoni se ata janë të përçarë në fise, bajraqe, fe e regjione, parti e fraksione. Jua them unë të vërtetën: Ata djem që u mundën në Koshare, që ju mposhtën dhe ju turpëruan - janë nga të gjitha viset shqiptare, gegë dhe toskë, myslimanë dhe të krishterë, të djathtë dhe të majtë, por janë unikë dhe të fjalës, dhe shembulli më i mirë janë komandantët e tyre: Agim Ramadani, Sali Çekaj, Xhemajl Fetahaj, Abaz Thaçi, Ali Hasi e shumë e shumë të tjerë.

Këta djem jua hoqën kufirin, e kthyen shpresën, kurse ju po i numëroni ditët e fundit. Në qendrat e tyre po përgatiten me mijëra të rinj që të mësyjnë kufirin në Maje të Pllumit, Qafë të Prushit, Koritnik dhe ne do t'i mbrojmë nga ajri. Ju i keni vetëm dy mundësi: ta pranoni, në marrëveshje me NATO-n, tërheqjen, apo të kapitulloni para Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Të nderuar deputetë,
Në lozhën e këtij Kuvendi janë familjarët e heronjve dhe dëshmorëve, stafi komandues i Betejës së Koshares...

(Duartrokitje)

...janë po këta, që para 14 vjetëve, nën komandën dhe urdhrat e kolonelit Rustem Berisha sollën vendime të rëndësishme për çështje të kombit.

Në shenjë respekti për të gjithë veteranët, invalidët, dëshmorët, heronjtë dhe për të gjithë ata që në çfarëdo mënyre u flijuan dhe kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ju lus që t'i përshëndetim me duartrokitje.

(Duartrokitje frenetike)

Lavdi të gjithë të rënëve për liri! Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Nëpërmjet kësaj seance të Kuvendit të Kosovës, sot, pas 14 vjetëve, po e kujtojmë njëherë nga betejat më të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, atë të Koshares.

Kjo betejë u zhvillua në kuadër të një ndërmarrjeje të gjerë ushtarake, e organizuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Qeveria e Përkohshme e saj, i njohur si operacioni "Shigjeta".

Si e tillë, Beteja e Koshares e kishte rëndësinë e saj strategjike, sepse e shënonte thyerjen e bllokadës ushtarake të Serbisë në kufi me Shqipërinë, e cila përgjatë gjithë kësaj vije

kufitare kishte përqendruar forca të mëdha ushtarake, policore e paramilitare, si dhe makinerinë e shumtë luftarake.

Thyerja e kufirit, e cila në fakt ishte pjesë e programit politik të çdo organizimi klandestin të pas-Luftës së Dytë Botërore e krijonte korridorin aq shumë të nevojshëm për futjen e luftëtarëve e të armatimit në Kosovë, në kohën kur brenda saj lufta kishte arritur kulminacionin dhe popullata civile shqiptare po i nënshtrohej shpërnguljes dhe gjenocidit të paparë në historinë e re të njerëzimit.

Përgatitja morale dhe profesionale e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte në nivel të lartë, kurse dashuria për lirinë dhe atdheun, si dhe urrejtja për armikun ishte e pakufishme. Mijëra djem e vajza, gra e burra, nga të gjitha viset shqiptare dhe nga Diaspora po ecnin rrugës së komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari.

Ata po ecnin në atë rrugë, se ajo rrugë kishte hapur perspektiva të reja. Ata po e ndienin si të dehur erën e lirisë, e cila po ndihej në këto troje, pas më se një shekulli robërie. Iu bashkuan këtij operacioni, i cili ishte planifikimi më serioz luftarak i kohës.

Në Betejën e Koshares ranë 84 dëshmorë, veprimtarë politikë e ushtarakë, si Xhemajl Fetahu, Agim Ramadani, Sali Çekaj e dhjetëra ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përderisa edhe humbjet e armikut ishin shumë të mëdha.

Sot, duke u përkulur para kujtimit të dëshmorëve të Koshares, krenaria jonë e ligjshme për madhështinë që ata i dhanë atdheut të vet na bën më të fortë dhe më të vendosur për ta mbrojtur dhe përparuar lirinë e fituar me gjak dhe sakrifica.

Lufta e Koshares e zë vendin e merituar dhe rolin e veçantë në historinë e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe popullit të saj.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përbën kulmin e vlerave të popullit të Kosovës për liri e pavarësi dhe shquhet për drejtësinë e pastërtinë e saj, për karakterin çlirimtar, human e demokratik. Si të tillë, askush nuk mund ta njollojë apo ta nëpërkëmbë atë.

Krismat, vrasjet përreth këtij kufiri e kanë pushuar në Kosovën e lirë, të pavarur e demokratike. Kufijtë e dikurshëm të ndarjes së shqiptarëve, të vendosur padrejtësisht janë kthyer sot në kufij të bashkëpunimit e të integriteteve.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Nesër bëhen 5 vjet nga miratimi i aktit më të lartë juridik të vendit tonë dhe e shfrytëzoj këtë rast që të jua uroj 5-vjetorin e miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila sanksionon fitoret tona dhe përcakton të ardhmen evropiane të shtetit tonë - Republikës së Kosovës.

Lavdi dëshmorëve të Koshares e të Pashtrikut!
Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!
Faleminderit!

* * *

Të nderuar të pranishëm, ju falënderoj për pjesëmarrje dhe me kaq i përmbyllim punimet e kësaj seance.

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë